



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIĆ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBLIC

Nr. Br. No.

01-060-01-7915-24

Nr. i fq. / Br Str. / No pg.

Data / Datum / Date 19. 03. 2024

OBLIQ - OBILIĆ - OBLIC



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBLIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBLIC**

KUVENDI KOMUNAL OBLIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt. 28.02.2024, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Florije Jashari (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Valon Svirca (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Bajram Hashani (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic (SL).

Të pranishmit tjerë: Ibush Mjekiqi, Nënkyrytar i Komunës, drejtoret komunal, Fatime Pllana, udhëheqëse e sektorit për Arsim, Ganimete Aliu, zyrtare për barazi gjinore Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun dhe përf. e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloj mbledhjen me këtë:

R E N D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit Komunal për vitin 2023
4. Shqyrtimi i kërkesës nga DKA-ja, për shqyrtim të Projekt Rregullores për organizimin e punës të shkollat fillore të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, udhëheqësit, mësimdhënësit, nëpunësit profesional, mbështetës, nxënësit dhe masat disiplinore
5. Shqyrtimi i kërkesës së DKRS-së për Draft Statutin e Bibliotekës Komunale të Qytetit
6. Shqyrtimi i kërkesës nga DAP-ja, për Raportin e Performancës të Komunës së Obiliqit për vitin 2022
7. Shqyrtimi i kërkesës së DMM-së, për shfuqizimin e vendimit nr.-I-94, të dt. 07.06.2019
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme

**Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 16 vota për.
Pika 1 e rendit të ditës**

Ë� gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 19 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën e Kryetarit të Komunës për raportin e punës dhe Ekzekutivit Komunal për vitin 2023.

Ibush Mjekiqi – Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, si rezultat i punës 12 mujore të angazhuar maksimal në shërbim të qytetit dhe fshatrave ju paraqesim raportin vjetor për vitin 2023 para juve, raport ky i projekteve dhe të arriturave të sfidave që po na presin së bashku. Ky raport pasqyron angazhimet tona të përbashkëta për aktivitetet, të arriturat, sfidat dhe planet për të ardhmen e qytetit tonë. Raporti vjetor i punës tonë është mjet i rëndësishëm për transparencën tonë të plotë dhe llogaridhëni para juve. Risi për vitin 2023 ishte edhe forma e hartimit të buxhetit, buxhetimi me pjesëmarrje, formë kjo që u realizua në fshatin Mazgit dhe është i planifikuar për buxhetin e vitit 2024 në buxhetin komunal. Viti që e kemi lënë pas ishte vit i vështirë për të gjithë ne, por së bashku kemi arritur ti përbushim obligimet karshi juve sepse duke qenë së bashku kemi të arritura që kalojnë të gjitha sfidat që ishin para neve. Ne me vendimet e marra jemi munduar që sado pak të zbutim krizën që nga lindja, udhëtimi, shkollimi, transporti, subvencionet e deri te shërbimet mortore. Ne 2 herë brenda vitit ju kemi informuar për sfidat dhe punët e përbashkëta. Bazuar në grandin e performancës të Komunave të Kosovës, Komuna e Obiliqit renditet e dyta në nivel vendi për vitin 2022 dhe synimi ynë është që të jemi në vendin e parë. Këto të arritura janë falë jush në kontributin e dhënë në dëgjimet buxhetore dhe takimet tjera, ku ju keni kryer obligimet qytetare duke bërë që buxheti i planifikuar të realizohet në masën prej 97.83 % edhe pse kemi marrë vendim në Kuvendin Komunal për lirim të taksapaguesve deri në masën prej 100 euro. Shpenzimi i buxhetit për investime kapitale për vitin 2023 është në masën 99.72 % dhe kjo është puna e palodhshme e zyrtarëve komunal dhe ekipit mbështetës. Projekti më madhor i Komunës së Obiliqit ka filluar kogjenerimi, shtrirja e rrjetit të sistemit të ngrohjes qëndrore në Obiliq, plani zhvillimor i Komunës së Obiliqit 2023-2031 zgjerimi i sheshit të qytetit, do të thotë veçova këto 3 aktivitete madhore duke mos lënë anash edhe tjerat. Ne kemi vazduhar me investimet kapitale në infrastrukturë, shëndetësi, kulturë, rini, sport e tjera. Bashkëpunimi me institucionet qëndrore e organizatat tjera ishte i vazhdueshëm, partneritet me USAID-in, OSBE-në, DEMOS-in e tjera.

Enver Gashi – Ky është një raport i sukseseve sepse vetë fakti që është 99.72 % i shpenzuar buxheti shihet se më pak se 0.5 % iu ka afruar qind për qindëshit do të thotë se është vit i sukseseve dhe rapporti është me kohë dhe i mirë. Ne kemi pranuar edhe raporte tjera si raportin 3 mujor, 6 mujor prandaj edhe i uroj suksese Kryetarit bashkë me Ekzekutivin dhe me neve.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga DKA-ja, për shqyrtim të Projekt Rregullores për organizimin e punës në shkollat fillore të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, udhëheqësit, mësimdhënësit, nëpunësit profesional, mbështetës, nxënësit dhe masat disiplinore.

Enver Gashi – Kjo kërkesë e DKA-së, ka qenë edhe një herë në Kuvend për me marrë vizën për me dalë Rregullorja në diskutim publik, dhe meqë i ka kryer të gjitha procedurat ligjore të mundshme, ne jemi për atë që të kaloj.

Xhelal Krasniqi – Ne e kemi lexuar këtë Rregullore dhe e kemi parë se është një Rregullore e duhur për organizimin e sistemit arsimor parauniversitar. Realisht si kërkesë dhe lutje për me rregullue edhe më mirë sistemin arsimor dhe univeristar në Kosovë edhe pse me lligj kjo në njëfarë mënyre nuk parashihet të ketë një orë të rregulltë javore të kujdestarisë sepse është e domosdoshme për shumë arsyet. Kjo do të ndihmonte në mbështetjen dhe përmirësimin e përvojës së nxënësve në shkolla dhe kujdestarët janë në gjendje të ofrojnë ndihmë në menaxhimin e konfliktive ose ngatërrresave, monitorimin e sjelljes si dhe ndihmën emocionale për nxënësit. Përveç, kësaj orët e kujdestarisë mund

të jenë për një kohë të rëndësishme për të identifikuar, arsyetuar dhe adresuar çështjet e ndryshme sociale që me mësimnxënies që do të ndikonte direkt në zhvillimin e nxënësve. Unë kisha kërkuar si asambleistë nga Drejtoria e Arsimit të insistojnë në organet përgjegjëse të shtyhet, të rregullohet ose me Udhëzim administrativ, ose me ndonjë ligj format të duhur të futet në procesin edukativo-arsimor edhe një orë e kujdestarisë. Mirëpo, mos të merret nga orët që ligjerojnë dhe ti kushtohet sjelljes së nxënësve, mungesat apo problemet eventuale që mund ti kenë brenda procesit mësimor.

Kryesuesja – Nëse, jam në dijeni kjo çështje nuk është e rregulluar me Udhëzim administrativ, prandaj edhe nuk është përfshirë në këtë Rregullore.

Valbonë Beka – Këtu, thotë se duhet të mbahet një orë kujdestarie, por faktikisht mbahet brenda orarit të mësimit, e jo orë e veçantë. Unë sa kuptova u kerkua me vendosë edhe një orë kujdestarie sigurisht me pagesë dhe nuk e përmendi normë.

Fatime Pllana – Komisioni disa herë e ka diskutue çështjen që e ceku z.Xhelal, por deri tash ne nuk e kemi normë. Në kuadër të normës së mësimdhënësve nuk është orë e kujdestarisë. Unë sa jam në dijeni drejtori na ka thënë se në një takim janë duke e shqyrtaur këtë mundësi, por deri tash nuk kemi të definuar asgjë. Mirëpo, duke i parë vështirësitë në shkolla ne kemi kërkuar që të mbahet kjo orë dhe realisht duhet të mbahet si orë shtesë sepse tjetër mundësi nuk ka.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 20 vota për morën Vendim për aprovimin e Rregullores për organizimin e punës të shkollat fillore të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, udhëheqësit, mësimdhënësit, nepunësit profesional, mbështetës, nxënësit dhe masat disiplinore.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kérkesën nga DKRS-ja, për aprovimin e Draft Statutit të Bibliotekës Komunale të Qytetit.

Enver Gashi – Edhe kjo kérkesë ka qenë në Kuvend dhe ne i kemi dhënë vizën që të shkoj në debat publik si dhe janë bërë të gjitha plotësim ndryshimet që janë kërkuar. Ne si grup jemi për që të kaloj.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 18 vota për morën Vendim për aprovimin e Statutit të Bibliotekës Komunale të Qytetit.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kérkesën e DAP-së, për raportin e performancës të Komunës së Obiliqit për vitin 2022.

Ibush Mjekiqi – Sa i përket raportit të performancës siç jeni të informuar edhe ju Komuna e Obiliqit është rendit në nivel vendi në vendin e dytë që nënkuption edhe masën buxhetore të fituar nga ky grand me punën tonë të përbashkët duke filluar nga Kuvendi dhe zyrtarët tjerë komunal të përfshirë në këto procese. Grandi i përfituar për vitin 2022 i cili do të shkoj në investime kapitale për këtë vit është 707,000 euro, ndërsa në nivel vendi sa i përket raportit të performancës që nënkupton dhënien e llogarisë jo të grandit, por të raportit tjetër që e bën MAPL-ja, Komuna jonë është rendit në vendin e katërt. Sa i përket indikatorëve me të cilët matet llogaridhënia dhe performanca, atëherë janë dikund 119 indikatorë dhe ne i kemi plotësuar shumicën prej tyre, prandaj edhe është renditur në vendin e dytë. Ndërsa, për me qenë pjesë e performancës së mirë komunale janë 3 kushte bazike raporti i auditorit që është i pamodifikuar për atë vit, realizimi i buxhetit mbi masën 70 % dhe vendimet e Kuvendit të kryera me kohë.

Enver Gashi – Është një e mirë që po diskutohet, një raport i performancës ku Komuna jonë është në renditjen e dytë në nivel vendi dhe ne i urojmë suksese Ekzekutivit, Kuvendit dhe të gjithë atyre që kanë marrë pjesë që ky raport të jetë pozitiv. Uroj që në vitin 2023 ta mbërrij vendin e parë e 2024 vendin e parë por më të qëndrueshëm dhe suksese.

Labinot Mirena – Unë e kam një propozim që të merret një vendim për ndarjen e një shume simbolike të mjeteve për zyrtarët reportues të performancës.

Ibush Mjekiqi – Është diskutuar dhe është menduar për këtë punë, por nuk ka Udhëzim ose procedurë administrative që e rregullon këtë çështje. Për shembull një prej Komunave e cila është diskualifikuar

në raportin vjetor për vitin 2022 është një Komunë që nuk po ia përmendi emrin që është beneficu, por në raportin e auditorit është dalë negativ, prandaj ne nuk mund ta bëjmë pa u rregullue kjo çështje.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga DMM-ja, për shfuqizimin e vendimit nr.-I-94, të dt.07.06.2019 për mbrojtjen e vlerës së natyrës “Trungjet e rrënjes” (Quercus robur) në Sibofc të Obiliqit si monument i natyrës.

Enver Gashi – Ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar këtë kërkesë dhe këtu bëhet fjalë për 2 lisa të mëdhenj në lagjen e Mexhuanëve, afér xhamisë. Ne si grup kemi vendos që mos të kaloj në këtë mbledhje derisa Ministria, të japë përmes Drejtorisë arsyetime shtesë sepse po ná duket se është pak ky arsyetim që e kanë bërë.

Shaip Paloja – Edhe unë mendoj se ky vendim nuk duhet të shfuqizohet me vetë faktin se kur është nxjerrë një vendim është parë një arsy shumë e madhe për me u nxjerrë një vendim i tillë me hy në trashëgimi këta drunjë me një periudhë dikund 200 vjeçare. Shumë thjeshtë ne e shfuqizojmë vendimin dhe ata drunjë duhet sipas atyre që i shpronësojnë të djegen për zjarr apo nuk e di se për çka tjetër. Paraprakisht mendoj se ata drunjë që i shpronësojnë Qeveria dhe korporata duhet të bisedojnë me banorët se ku mendojnë së paku trupat e tyre të vendosen dikund dhe të ruhen aq sa ka mundësi edhe për një periudhë shumë shumë më të madhe. Ata nuk e kanë bërë as nuk e kanë sqaruar këtë punë. Mua, më kujtohet një delegacion i Kuvendit Komunal të Obiliqit, një herë ka shkue në Gjermani me pa qysh shpronësohen tokat atje, në interesin publik dhe ata kur janë kthyesh thanë se në një vend ku ishte një liqen besoni atë liqen qysh ka qenë në atë tokë ku kanë jetue ata, të njejtin ua kanë ndërtue në vendin ku i kanë vendosë. Këtu, te ne interesin publik po e kuptoj, por interes më publik dhe më me interes nacional se jeta e vetë banorëve dhe interesi i tyre nuk ka kurgjë hiç. Prandaj, mendoj se ky vendim nuk duhet të shfuqizohet dhe duhet të kërkohen sqarime të mëtutjeshme çka do të bëhet me ata drunjë si dhe çka do të bëhet me vetë zhvendosjen e asaj popullate.

Ibush Mjekiqi – Po, dihet për trashëgiminë e këtyre drunjëve është një e mirë që janë futë në listën e trashëgimisë të monumenteve të natyrës. Edhe unë pajtohem me ju që sot mos të kaloj ky vendim sepse ekziston Institut i përmbrojtjen e monumenteve të natyrës dhe le ta bëjnë një analizë se a mund të bartën dhe të vendosen dikund tjetër edhe pse personalisht mendoj se është shumë e vështirë. Mirëpo, edhe në anën tjetër të llogarisim një kosto se sa kanë vlerë ato sepse Komuna jonë po e humbë një trashëgimi kulturore e cila s'ka të paguar, por sido që të jetë e kanë një kosto se sa do të kushtojnë dhe si do të veprohet me ata drunjë. Prandaj, jam i pajtimit se nuk është punë e ngutshme, KEK-u nesër nuk fillon me aksplorativët në atë zonë aty, kështu që mendoj në këtë seancë të mos kaloj.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 20 vota për e shtyen shfuqizimin e vendimit nr.-I-94, të dt.07.06.2019 për mbrojtjen e vlerës së natyrës “Trungjet e rrënjes” (Quercus robur) në Sibofc të Obiliqit si monument i natyrës.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga Zyra për integrime evropiane, që të prezentohet në mbledhje Raporti për planin vjetor 2023 për integritet. Te rekondimet në faqet e fundit nën 3 e keni se Kuvendi Komunal duhet të hartoj dhe aprovoj Kodin etik të sjelljes për asambleistët e Kuvendit. Dua të ju njoftoj se kemi një shkresë nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ku e kemi aprovuar Kodin etik për të gjithë zyrtarët e Komunës së Obiliqit dhe MPB-ja, na ka thënë se konsiderojmë se vazhdimi mëtutje i miratimit të Kodit etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit është i panevojsém dhe nuk është në harmoni me rregulimin e njëtrajtshëm për të gjithë zyrtarët publik. Kjo, për arsy se Rregullorja në fjalë e sponsorizuar nga ish Ministria e administratës publike, tash fushëveprimi i Ministrisë së brendshme e mbulon tërë rregulimin që e parashehë Kodi etik. Anëtarët e Kuvendit janë zyrtarë dhe Kuvendi nuk mundet me nxjerrë një Kod etik të veçantë prandaj kërkoj të largohet dhe të mos ekzistoj si e gjetur për Kuvendin Komunal.

Ajet Berisha – Është hera e parë që bëhet ky rapport dhe thuhet ka progres në rapport, me çka ka progres, ka mangësi por meqë është hera e parë nuk është e thënë domosdoshmërisht me konstatue këta sepse

nuk kanë raport me çka me konstatue atë progres. Mendoj se e kanë bërë një vlerësim jo të mirë në kuptimin e asaj ka progres në raport me të kaluarën, në raport me çka.

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga Qendra për promovimin e të drejtave në Drenas, për Komunën e Obiliqit për mbështetje për hapjen e Këndit të kurajos brenda hapësirës së objektit të Komunës, për të iu ndihmuar dhe fuqizuar viktimat e dhunës seksuale në Kosovë me mjete buxhetore në shumën prej 800 euro. Ne këtë kërkesë në mbledhjen e KPF-së ia kemi rekomanduar DEFZH-së dhe drejtoresha ka dhënë përgjegje sa i përket kërkesës në fjalë dhe gjetjet e Zyrës Kombëtare të Auditimit kemi marrë vërejtje, rekomandime që mbështetja për OJQ-të, duhet të bëhet bazuar në Rregulloren nr.04/2019 si dhe thirrjeve publike të planifikuara nga Drejtoritë përgjegjëse. Sa i përket OJQ-ve, në mes të Komunave të ndryshme, ju e dini se këto bashkëpunime mund të realizohen përmes memorandumit ndërkunal. Pra, siç shihet ne nuk mund të marrim vendim nga përvojat e mëhershme.

Pika 9 e rendit të ditës

Kryesuesja - E kemi një kërkesë nga MAPL-ja, për rishqyrtim të vendimit nr.01-060-01-3834-24, i dt.06.02.2024, për shpallje të përgjithshme të interesit publik në zonën kadastrale Milloshevë dhe Obiliq. Unë propozoj që ky vendim të shfuqizohet.

Enver Gashi – Ne si grup jemi për atë që të shfuqizohet ky vendim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 13 vota për dhe 4 vota abstenim morën Vendim për shfuqizimin e vendimit nr.01-060-01-3834-24, i dt.06.02.2024, për shpallje të përgjithshme të interesit publik në zonën kadastrale Milloshevë dhe Obiliq.

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga MAPL-ja, për rishqyrtim të vendimit nr.01-060-01-3846-24, i dt.06.02.2024 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Njësitë Kadastrale në Zonën Kadastrale në Llazarevë dhe Milloshevë. Paraprakisht kërkoj që drejtori i DPUKP-së, të na sqaroj çështjen.

Arben Berisha – Ju sqaroj se në vitin 2023 në muajin e pestë e kemi të njejtën komplet qysh e kemi bërë ashtu na ka ardhë ligjshmëria e vendimit dhe jemi në harmonizim me ligjin dhe me Udhëzimet administrative. E njejta, e kemi emailin ku kryesuesja iu ka drejtue zyrtarëve të Ministrisë dhe në email e shkruajnë se çka duhet me pasë për me qenë i ligjshëm. Në harmonizim komplet me krejtë këto, por edhe në bazë të praktikës dhe emailit ne e kemi përpilue propozimvendimin dhe ua kemi dërgue juve. Ministria thotë se duhet me pasë edhe pëlqimin nga AKP-ja. AKP-ja, është organ menaxhues i pronave të shtetit dhe nuk është pronare e pronave të shtetit sepse toka e shtetit është e Qeverisë dhe Parlamentit. Ne tash bëjmë kërkesë absurde që nuk ka ndodhë asnjëherë në AKP dhe e marrim pëlqimin dhe në pëlqim të AKP-së, shikone çka thotë edhe pse me ligjin e shpronësimit nuk kërkohet shpronësimi në Agjensionin kadastral. Ne ua japim atë pëlqim, por nuk kërkohet me ligj dhe e kemi marrë edhe këtë. Në arsyeshmërinë e vendimit që Ministria, e kthen tash thirret në nenin 27 që ne jemi thirrë në bazë të ligjit, por në nenin 27 që Komuna ka të drejtë bartjen e pronës nga niveli qëndror në nivelin lokal. Tash, thotë për bartjen e pronës nga institucioni qëndror ndërsa, në përbajtjen e mëposhtme të vendimit thotë se do ti ndjekë procedurat e shpronësimit pranë MMPHI-së. Unë e kam pasë një takim nëse nuk gaboj të hënën, ose të martën dhe thotë se na ka mbetë blanko arsyeshmëria dhe vetëm atë ua kemi dërgue. Unë me shkrim nuk e kam atë fjalë, por e kam këtë me shkrim që thotë se kthehet e jashtëligjshme për arsyet që keni thënë se do ti ndjekë procedurat e shpronësimit pranë MMPHI-së. Unë nuk dua të them që është puro politike, por nuk është në rregullë nga ana e Ministrisë sepse preamble dhe arsyeshmëria e tyre që besoj se e keni marrë pse duhet të rishqyrtohet vendimi. E kemi nxjerrë një propozimvendim për këtë seancë, që e keni përpara edhe ju me shkresën e Ministrisë, dhe ua kemi heqë komplet ato për arsyet se interesit i Komunës është hapi i parë me shpallë zonë me interes. Hapi i dytë është me hy në procedurat e shpronësimit duke arsyetuar arsyeshmërinë e mjeteve, bazën ligjore, vlerësimin e parcelave në Ministri në Departamentin e vlerësimit që është në Ministrinë e financave dhe me u drejtue edhe deri te AKP-ja. Ne e kemi edhe këtë praktikë se jemi Komuna numër 1 që kemi bërë edhe shpronësimet dhe marrje nga niveli qëndror në nivelin lokal dhe në bazë të praktikave këto i kemi kryer. Për shembull kemi ble stadionin dhe shkollën "Ibrahim Rugova" 20 %-in, që ne e kemi paguar dhe procedurat janë këto. Tash, po kërkohet me u bë edhe kjo, e bëjmë edhe

këtë, por sinqerisht kjo nuk është në rregullë. Ne kemi kërkuar kryesuese me rishikue edhe një herë këtë propozimvendim të Kryetarit dhe në bazë të propozimit tonë me hudhë edhe një herë në votim. Është në përgjegjësi tonë jetik për arsyen e interesit që neve na i ka marrë parcelat tjera Komuna e Prishtinës solar4kosovo dhe na duhet me sigurue një lokacion për të zhvendosurit në të ardhmen.

Kryesuesja – Është propozimvendimi ku ju pasi keni biseduar me MAPL-në, po kërkoni të ndryshohet vetëm preambula, të hiqet nen 27 i Ligjit nr.06/L-92 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës dhe të futet Ligji nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, do të thotë gjithçka është e njejtë vetëm preambula lartë të ndryshohet në vendimin e njejtë.

Arben Berisha – po, unë po i referohem edhe kontaktit që kemi pas me Ministrinë dhe vetë ata persona na kanë thënë hiqe këtë e vendose këtë dhe prapë e kthejnë prapa.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që të aprovohet kërkesa e Drejtorisë dhe besoj të jetë hera e fundit ky votim e të mos kemi më punë me këto prona.

Sami Ahmeti – Unë u inkuadrova vonë dhe fakti që këto dokumente nuk i kemi marrë më heret vazhdon të jetë sfidues për neve si asambleistë. Sido që të jetë këtu u folë për çështje politike, por askund nuk po e shohë se ministri, apo zëvendësministri kanë nënshkruar diçka, janë zyrtarët e njejtë që i kanë shqyrtau ligjshmëritë vazhdimisht. Ndërsa, sa i përket AKP-së, është dashtë ju me i krye ato atje dhe s'ka nevojë ju me na i shpjegue këtu fare. Çështja e pronave, sikur qysh e kemi cekë edhe më heret tashmë sigurisht edhe nëpër Ministri po shihet me dyshim dhe këtë janë rezultatet. Ne do të abstenojmë në këtë fazë.

Kryesuesja – Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, shkojmë në votim sipas kërkesës nga MAPL-ja dhe shpegitim që e dha drejtori bëhet plotësimi dhe ndryshimi vetëm i preambulës të vendimit, hiqet Ligji nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës dhe zëvendësohet me Ligjin nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme të Komunës me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/L-205.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 13 vota për dhe 6 vota abstenim morën Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Njësitë Kadastrale në Zonën Kadastrale në Llazarevë dhe Milloshevë.

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga Kryetari i Komunës për plotësim ndryshimin e vendimit të KKSB-së, në vend të Agon Dragushës të jetë Rexhep Qerkezi.

Enver Gashi – Ata e kanë bërë ndërrimin dhe ne e votojmë.

Sami Ahmeti – Ne do ta përkrahim kërkesën, kështu që do të votojmë pro.

Shaip Paloja – Nëse, bën vetëm një sqarim fillimisht shkruan aty në kushtetutën e Bashkësisë Islame, nuk po e kutpoj a mundet dikush me ma sqarue këtë.

Ibush Mjekiqi – Sqaron se akti më i lartë i organizimit të Bashkësisë Islame rezulton me kushtetutë, do të thotë kushtetutë e quajnë organizimin më të lartë në nivel të vendit të Bashkësisë Islame.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal unanimisht morën Vendim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.-I-154, të dt.30.11.2023 për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) duke zëvendësuar anëtarin z.Agon Dragusha me z.Rexhep Qerkezi.

Labinot Mirena – Unë e kam një kërkesë që aksionarët e zgjedhur prej këtij Kuvendi në NPL “Kastrioti” që janë të marrim një vendim dhe të bëhen me pagesë.

Ibush Mjekiqi – Propozoj se sot nuk mund të marrim vendim për këtë çështje, por le të mbetet të bisedohet dhe të gjendet rruga ligjore nëse, Kuvendi mund të merrë vendim apo jo.

Labinot Mirena – Nënkryetar, ne e kemi pasë një takim dje që e mbajmë çdo muaj me shefin e grupit parlamentar dhe kemi diskutue. Është vendimi i njejtë qysh është marrë për aksionarët që janë në kompaninë “Pastrimi” që e kemi marrë ne si Asamble, është i ligjshëm dhe jemi në pajtim si grup parlamentar që me marrë vendim edhe për aksionarët që janë në kompaninë NPL “Kastrioti”.

Kryesuesja – Po, është e vërtetë se Kuvendi Komunal ka marrë vendim për NPL “Pastrimi” dhe një vendim i tillë ka ardhë i ligjshëm nga Ministria, Tani, kërkohet të merret i njeiti vendim edhe për aksionarët e NPL “Kastrioti”

Ibush Mjekiqi – Mendoj se kjo çështje nuk duhet të hyj në pikën të ndryshme, por të bëhet kërkesa nga Drejtoria përkatëse, le të përfshihet në rend dite për mbledhjen e ardhshme dhe marrim vendim.

Shaip Paloja – Drejtoria nuk kanë mundësi me bë kérkesë sepse aksionarët nuk i përgjegjen asnjë Drejtorie dhe është pronë e Komunës njëqind për qind, do të thotë asnjë Drejtori nuk e ka të drejtën me kérkue që të paguhen komisionerët që janë aksionarë.

Ibush Mjekiqi – Nëse, nuk e kanë Drejtoriat atë të drejtë atëherë, e ka Kryetari

Abdyrrahman Krasniqi – Sa i përket pagesës nuk nxjerret vendim për pagesë, por realisht në momentin që nxjerret vendimi që të ketë aksionarë në një kompani të caktuar, tash kanë fillue me i bë pagesat. Prej muajit janar kanë fillue me i bë pagesat në KRM “Pastrimi” ndërsa më heret nuk kemi bërë pagesa. Unë nuk besoj se ka nevojë me nxjerrë vendim për pagesë sepse në momentin që janë të zgjedhur aksionarët vendimin e kanë, por duhet të shikohet mënyra si të paguhen. Kërkesa duhet të vjen prej një Drejtorie të caktuar për pagesë dhe duhet të shihet ligji se qysh e rregullon. Pajtohem me Nënkryetarin se nuk është mirë të ngutemi me nxjerrë vendime të dyfishta, por me trajtue lëndën dhe në seancën e ardhshme të shihet se si do të veprojmë.

Labinot Mirena – Vendimi duhet të nxjerret ashtu qysh është nxjerrë për aksionarët e KRM “Pastrimi” do të thotë njejtë edhe për këtë vendim. Atë vendim ne e kemi nxjerrë këtu në Asamblenë komunale dhe e kemi votuar ne si përfaqësues të popullit. Ai vendim ka kalue dhe ka shkue mëtutje, kështu që duhet të kaloj edhe ky vendim për këta tjerët. Nëse, është i jashtëligjshëm ai tjetri atëherë duhet të anulohen që të vendimet.

Kryesuesja – Pyeti se a pajtoheni që në mbledhjen e radhës ta dërgojmë bashkë me rend dite propozimvendimin dhe të votohet.

Labinot Mirena – Jo, nuk pajtohami.

Ibush Mjekiqi – Unë propozova që të mbetet për mbledhjen e radhës, por nëse, insistohet shumë edhe le të votohet.

Bajram Hashani – Edhe unë e përkrahi mendimin e z.Labinot Mirena, pasi që ka kaluar një vendim në këtë formë, le të kaloj edhe ky vendim, le të hudhet në votim dhe jam për me votue.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 13 vota për dhe 6 vota abstenim morën Vendim për kompensimin e anëtarëve të Komisionit komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale NPL “Kastrioti” SH.A me këtë përbërje: 1.Naim Miftari, Kryetar, 2.Shaip Paloja, anëtar i Kuvendit dhe 3.Bajram Hashani, anëtar i Kuvendit.

Sami Ahmeti – Në mbledhjen e KPF-së, i kam bërë 2 kérkesa dhe e para ka qenë çështja të bisedohet ose të trajtohet kérkesa e parcelës për varreza në Milloshevë, kérkesë kjo që sipas informatave që i kemi edhe nga imami i fshatit është kérkesë shumë urgjente. E thashë që jemi të gatshëm me bashkëpunue pa pasë nevojë me përmendë terma politikë sepse kjo është për të gjithë dhe është diçka shumë e nevojshme, edhe është mirë me pa se çka mundemi ne si Kuvend me bë. Imami i fshatit e ka identifikue një parcelë e cila është shumë e rëndësishme me iu bashkangjitet varrezave, që tashmë janë. Mendoj se ka qenë mirë të bisedohet kushdoqoftë jam në dispozicionin e juaj në këtë drejtim që nëse, kemi mundësi qoftë me shpallë parcelë me interes të veçantë për shkak se pronari veç po dihet në mënyrë që të bëhet një zgjidhje. Ju lus shumë që ta shihni si kérkesë serioze sepse është kérkesë bazike që do të duhej të merreshim me të.

Kryesuesja – Në mbledhjen e KPF-së, kérkesat i kemi adresuar në Drejtoriat përkatëse.

Sami Ahmeti – Kjo ishte kérkesa e parë, por ka qenë edhe një kérkesë tjetër që drejtori i Arsimit me na raportue lidhur me disa çështje nëse është këtu, e nëse jo unë e kam edhe kérkesën e dritave gjithandjej nëpër qytet dhe fshatra që vazhdojnë të janë me defekt. Ka qenë një tender i cili, është stërvizgjatë, është shkue në rivlerësim e vlerësim, në ndërkohë që ndryshimi nuk po duket dhe kisha pasë dëshirë me ditë se ku jemi.

Valon Svirca – Pasi u përmendën varrezat, e kemi të njejin problem në Mazgit dhe Nënkryetari e din. E kam një kérkesë më heret dhe tash te shohim.

Sami Ahmeti – Për dallim për Mazgit, se ka disa telashe që qytetarët nuk mund të dakordohen se ku apo diçka sa këshku kam marrë vesh, në Milloshevë ky problem nuk është dhe është edhe mbështetja e komunitetit për çka edhe janë zotue se janë të gatshëm të bashkëfinancojnë, ose të participojnë për çështje të shpronësimit.

Ajshe Haliti Pllana – Unë i kam 2 kërkesa nga banorë e fshatit Baimoc, është zgjidhja e çështjes së kanalizimit në atë fshat dhe asfaltimi i një rruge të shkurtë prej rrugës kryesore deri te xhamia, që dikund nuk është as 100 metra.

Ibush Mjekiqi – Përgjegjet sa i përket fshatit Baimoc, rrugës deri te xhamia banorët e kanë obligim së pari pronën me përcaktue dhe nëse, është pronë private nuk kemi me mund me shtrue. Unë nuk besoj se kemi me hasë në problem, por po ju them se kemi pasë edhe raste kur është bërë projekti, kemi fillue me realizue vijnë thojnë shtro, shtro rrugën dhe na padisin pse e kemi shtrue në pronë private. Prandaj, ne nuk vazhdojmë mëtutje pa e rregullue përmes procesit të shpronësimit, faljes e tjera, Sido qoftë të 2 projektet këtë vit do të realizohen në fshatin Baimoc. Sa i përket varrezave të Mazgitit, është e vërtetë se kjo kërkese është paraqitë edhe në përbërjet tjera të Kuvendit, e jo vetëm në këtë përbërje sepse shkon deri në fund mbushja e atyre varrezave edhe pse në një pjesë nga Hazirët më duket ka ende hapësirë për varrim. Po ashtu, në Milloshevë është problemi i kahmotshëm se dihet varrezat e vjetra kanë qenë te xhamia e vjetër dhe në një periudhë të mëhershme është bërë lokacioni ku janë tash varrezat e reja që janë nëpër 3 fshatra. Unë ju them me kompetencë të plotë se ne jemi duke punuar në atë drejtim për të gjetë mundësinë. Nëse, është i nevojshëm shpronësimi në Milloshevë të jeni të bindur se bashkarisht do ta bëjmë edhe me vendim të Kuvendit, me vendim të institucioneve tjera relevante. Ne do të punojmë që ta zgjidhim këtë problem jo vetëm për Milloshevë e Mazgit, por edhe për zonat tjera. Sa i përket ndriçimit, është e vërtetë që kontrata ka shkue nëpër OSHP dhe ka zgjatë shumë, pastaj e kemi bërë marrëveshjen me NPL "Kastrioti" dhe është rregullue, që nuk është se në gjithë territorin nuk është rregullue. Tani, e tutje vazhdojmë prapë me marrëveshje të njejtë për rregullimin e ndriçimit.

Kryesuesja – Drejtori mund të na sqaroj nëse, e keni shqyrtue kërkesën e xhamisë së Baimocit për blerjen e një tepihu.

Abdyrrahman Krasniqi – Sa i përket ndriçimit qyteti i Obiliqit, pothuajse është rregulluar fshati Palaj, pjesa e Grabofcit, Dardhishta, Mazgitat, rrugët kryesore, jemi duke filluar tash edhe nëpër lagje dhe do të kalojnë nga Millosheva. Unë kisha pasë një kërkесë për të gjithë anëtarët e Kuvendit, që ti stojnë qytetarët që mos ti ndalin dritat sepse ne po kemi shumë telashe sepse në shumë vende dritat janë rregulluar, por dikush po shkon dhe po i ndalë. Pastaj, po shkojnë 5,6 ditë derisa ne e marrim informatën se në rrugën e caktuar nuk po funksionojnë dritat. Unë e kisha ftuar z.Sami, që të loboj në këtë drejtim sepse janë disa aktivistë që rregullisht po na i ndalin dritat dhe besoj se kjo nuk është në rregullë sepse po i penalizojnë të gjithë qytetarët dhe të gjitha lagjet. Ndërsa, sa i përket tepihut ne do ta shqyrtojmë kërkesën dhe besoj se do të kryhet kjo punë.

Arben Berisha – Ne kemi qenë në takim edhe me Kryetarin dhe nuk e di tash a është zgjedhë ai Qerkezi apo z.Sami, Kryetar i Bashkësisë Islame. Ne kemi qenë me qytetarë dhe vendimin. Veç Kryetari e ka procedurë mëtutje për shpronësimin e atyre parcelave, Mirëpo, është çështje e bashkëfinancimit se ne duhet ta shohim mundësinë se si duhet të jetë harmonizimi i ligjit në bashkëfinancim me qytetsarët e asaj pjese sepse ata i kanë grumbullue disa mjete dhe tash duhet me pa ngâ cila vijë ne duhet me i marrë mjetet për me hy në procesin e shpronësimit të asaj parcele. Ndoshta, duhet me i nda vijat e investimeve, ata me bë ndonjë rrrethojë, por kryesorja kjo është në procedurë dhe komplet kjo duhet me u adresue përmes Kryetarit të Bashkësisë Islame.

Sami Ahmeti – Po adresohem pa politikë dhe nuk kemi nevojë me fye, të lutem edhe pse nuk i marrë shumë me rëndësi, nuk është problem. Asnjë centë nuk është ndarë, unë jam në bashkëpunim të ngushtë me qytetarë dhe me imamin e fshatit Milloshevë dhe kjo është në procedurë. Qytetarët janë deklarue se nëse, ka nevojë jemi të gatshëm me bë. Veç, me ndonjë sekser të pronave jo; jam takue me imamin e fshatit Milloshevë, ndërsa sa i përket z.Abdyrrahman që tha unë bëjë ftesë prej këtu e kudo qoftë, i ftoj direkt policinë e Kosovës dhe kushdo qoftë ai që dëmton dhe nëqoftë një letër që e gjuan në vende ku nuk

gjuhen të merren direkt me secilin që e shkelë ligjin. Ju, z.Abdyrrahman, janë 3,4 aktivistë e the të lutem shumë thuaj emrat menjëherë dhe posa dalë unë të shkoj në stacionin e policisë. Askush nuk guxon me dëmtue pronën shoqërore edhe aq më tepër unë sot po e di që paska mundësi qytetarët me i ndalë dritat, përveç me i dëmtue ato. Unë nuk e di qysh ndalen dritat, por unë jam i gatshëm nga këtu me shkue në stacion të policisë edhe me i lajmëruat ata persona, por thuaj në foltore kush janë 3,4 aktivistët që po i bëjnë këto dëme.

